

## PARA SE TË SHKONI NË AMBULANCËN E GASTROENTE-ROLOGJISË PËR BËRJEN E KOLONOSKOPISË, KONTROLLO- NI NËSE KENI GJITHÇKA QË NEVOJITET ME VETE:

- librezën shëndetësore me sigurim të konfirmuar;
- fletë-rekomandimin për kontrollin e kolonoskopisë, të marrë nga mjeku personal;
- pyetësin e plotësuar bashkë me mjekun tuaj të zgjedhur;
- rezultatet e mëparshme eventuale me dokumentacionin shëndetësor që shpjegon hollësisht gjendjen tuaj shëndetësore;
- librezën e kolonoskopisë, në të cilën keni shkruar pyetjet eventuale për mjekun; pyetjet për gastroenterologun mund t'i shkruani edhe këtu:

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

### Udhëzimet për pastrimin e zorrëve para kolonoskopisë paradite (kontrolli para orës 12.00)

*Për realizimin e suksesshëm të kolonoskopisë, zorrët duhen pastruar mirë para kontrollit. Është shumë e rëndësishme që gjatë përgatitjes për kontroll t'i respektoni këto udhëzime dhe udhëzimet e mjekut tuaj personal.*

#### NJË JAVË PARA KOLONOSKOPISË

- Siguroni në kohë preparatin për pastrimin e zorrëve MoviPrep.
- Konsultohuni me mjekun tuaj nëse preparati është i sigurt për ju. Përshtateni përdorimin e medikamenteve vetëm me këshillat e mjekut tuaj.
- Mos konsumoni bukë me miell integral dhe fruta me fara të vogla (rrush, kivi, domate – sepse farat mund të ngjiten në muret e zorrës dhe të pengojnë kontrollin).

Ju rekomandojmë që mos të shkoni vetëm në kolonoskopi, por t'ju shoqërojë dikush.

#### TRI DITË PARA KOLONOSKOPISË

- Mos konsumoni perime të gjalla, perime dhe fruta me lëkurë të kuqe (p.sh. domate, speca të kuq, mollë të kuqe, rrush etj), fruta me fara (p.sh. kivi, mjedra etj), prodhime me miell integral, fara dhe fruta të thata, misër.
- Hani bukë të bardhë dhe prodhime prej mielli të bardhë, patate të pastruara, mish pa yndyrë dhe peshk, perime të ziera dhe komposto.
- Kini parasysh të pini sasi të mjaftueshme lëngjesh (së paku 2 litra në ditë). Lëngjet duhet të jenë pa ngjyra, pa ngjyrë të kuqe (si p.sh. lëng panxhari, boronice...).

## NJË DITË PARA KOLONOSKOPISË


- **Vaktin e fundit me ushqim të ngjeshur mund ta hani 24orë para kolonoskopisë.**
- **Këtë vakt mund të hani:** bukë të bardhë, prodhime të pjekura dhe makarona me miell të bardhë, marmelatë pa fara frutash ose bërthama, mjaltë, mish pa yndyrë ose proshutë, peshk, puding, petulla, supë të hollë, lëngje të holla frutash, kornfleks misri dhe gruri, biskota, jogurt prej qumështi të skremuar, çaj dhe kafe pa qumësht.
- **Këtë vakt nuk duhet të hani:** ushqim me miell integral dhe krunde, musli, ushqim me ngjyrë të kuqe, fruta dhe perime, lëngje të trasha frutash.
- **24 orët e fundit para kolonoskopisë mos konsumoni asnjëfarë ushqimi të ngjeshur.** Mund të konsumoni vetëm lëngje të holla me sasi të pakufizuara (lëngje frutash të holla, pa ngjyra, vetëm supë, çaj dhe kafe pa qumësht, pije sportive me sasi të rekomanduara). Mos konsumoni qumësht, produkte bulmeti dhe lëngje të trasha.

**Gjatë ditës duhen pirë 2 litra uji Donat mg.**

## NË MBRËMJEN PARA KOLONOSKOPISË

### NË ORËN 20.00 FILLONI TË PINI MOVIPREP-in

MoviPrep është medikament për pastrimin e zorrëve në formë pluhuri, me të cilin përgatiten dy litra pije laksative me shije limonade. **Pijeni të gjithë sasinë e pijes**, sipas udhëzimit dhe, si shtesë, edhe deri në 1 litër lëng (ujë mineral, ujë, lëngje frutash të holla pa ngjyra, kafe ose çaj pa qumësht). Në mëngjes pini ilaçet si zakonisht (përveç atyre që duhen kapërcyer për arsye të kontrollit), por me sasi shumë të vogël uji.



Në paketim ndodhen dy komplete me qese. Në secilin komplet ndodhen nga dy qese: qesja A dhe qesja B. **Përzieri përmbajtjen e njëres qese A dhe njëres qese B nga kompleti i parë me një litër ujë me temperaturë dhome dhe përziejeni atë derisa pluhuri të shkrihet plotësisht.** Në të njëjtën mënyrë përgatitni edhe litrin e dytë të pijes. Pija mund të ruhet në frigorifer ose në temperaturë dhome më e shumta 24 orë. Këshillojmë që para përdorimit pijen ta ftohni, që të jetë më e këndshme për pirje.

## PËRGATITJA E PIJES LAKSATIVE

**Litrin e parë të pijes filloni ta pini në orën 20.00 të darkës një ditë para kolonoskopisë.**

Çdo 15 minuta pini 2,5 dl pije. Është e rëndësishme që për një orë të pini të tërë litrin e pijes. Nëse ju neveritet dhe ju vjen për të vjellë, dozën tjetër pijeni pas gjysmë ore dhe gjatë kësaj kohe shëtitni nëpër dhomë. Ecja ndihmon pastrimin më të mirë. Pas pirjes së litrit të parë, pini edhe gjysmë litri pije të hollë sipas dëshirës. Përafërsisht gjatë kësaj kohe do të fillojë pastrimi i zorrëve dhe do të shfaqet diarreja që do të vazhdojë rreth 2 orë.

**Litrin e dytë të pijes filloni ta pini në mëngjes, ditën e kontrollit, 5 orë para tij.**

Çdo 15 minuta pini 2,5 dl pije. Për një orë pini një litër të tërë. Pasi të keni pirë edhe litrin e dytë, pini edhe gjysmë litri pije sipas dëshirës. Përsëri do të shfaqet diarreja që do të vazhdojë rreth 2 orë.

**3 ORË PARA KONTROLLIT NUK DUHET TË KONSUMONI MË ASGJË, DERISA KONTROLLI TË PËRFUNDOJË.**